



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.690/22

GJYKATA KOMERCIALE-Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbare të kreditorit M... me seli në Prishtinë, ndaj debitorit “M... Sh.p.k” me ARB; ....., në Gjilan, me bazë juridike përmbare, duke vendosur sipas ankesës së debitorit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm - Devizioni Civil, CPK.nr.258/19 i datës; 16.03.2021, me datë 05.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit “M... Sh.p.k” me ARB; ....., në Gjilan, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm-Devizioni Civil, CPK.nr.258/19 i datës; 16.03.2021,dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar CPK.nr.258/2019, i datës 16.03.2021, në pikën I të dispozitivit ka vendosur ta hedh poshtë si të pas afatshëm prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhërit për Përmbare P.nr.786/19 të datës; 20.11.2019. Ndërsa në pikën II ka vendosur që të mbetet në fuqi Urdhërit për Përmbare i Përmbaresit Privat Rezarta Metaj nga Prishtina, me numër P.nr.786/19 të datës 20.11.2019, si dhe në pikën III ka obliguar debitorin “M... Sh.p.k” me ARB; ....., në Gjilan, që të paguaj taksën gjyqësore për ushtrimin e prapësimit në shumë prej 30 euro.

Kundër këtij aktvendimi ka parashtruar ankesë debitorit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës (*pretendime të kuptuara nga referati i ankesës*), me pretendim që prapësimi është i afatshëm, duke i propozuar gjykatës pranimin e ankesë, dhe të shfuqizojë aktvendimin e ankimuar.

Kreditori përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar edhe pse i njëjti e ka pranuar ankesën e debitorit me datën; 08.04.2021.

Ankesa e debitorit është e themeltë.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Nga shkresat e lëndës konstatohet së kreditorit ka paraqitur me datën 20.11.2019, propozim për përmbarrim, në bazë të dokumentit të besushëm. Përmbarruese privat Rezarta Metaj, nga Prishtina, sipas propozimit të kreditorit me urdhrin përmbarrimore P.nr.786/19, të datës 20.11.2019, ka lejuar përmbarrimin duke vlerësuar se dokumenti i besushëm - fatura me nr. 5626 e datës 30.08.2010, dhe faturën me nr.6472 datës.28.03.2011, i plotëson kushtet si dokument përmbarrues.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 02.12.2021 të njejtën e ka dorëzuar përmes postës e cila shifet sipas kopertinës që gjindet në shkresa të lëndës, me propozim që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa të refuzohet si e pa bazuar urdhri për përmbarrim P.nr.786/19 i dt. 20.11.2019.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas prapësimit të debitorit ka nxjerr aktvendimin e ankimuar CPK.nr.258/2019, i datës 16.03.2021, dhe ka vendosur ta hedh poshtë si të pas afatshëm prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhërit Përmbarrimor, P.nr.786/2019, i datës 20.11.2019.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar së debitori urdhërin përmbarrimor e ka pranuar me datën 23.11.2019, ndërsa prapësimin e ka ushtruar me datën; 04.12.2019, që nënkupton se debitori prapësimin e ka bërë jashtë afatit të paraparë ligjor ashtu siq parashihet në nenin 70 të LPP-së, ku përcaktohet se; *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë(7) ditësh pas pranimit të aktvendimit përmbarrues ose urdhërit përmbarrues.*

Dhoma e Shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 182.2 pika n), 183, 127 të LPK-së, e lidhur me nenin 29 paragrafi 1 pika 1.3 e lidhur me nenin 40 dhe 43 paragrafi 4 dhe 70 të LPP-së.

Dhoma e shkallës së Dytë në Prishtinë nuk mund ta pranojë mënyrën e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të ankimuar për arsyeje se, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale.

Dhoma e shkallës së Dytë në Prishtinë nuk mund ta pranojë këtë qëndrim dhe përfundim të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se nuk mund të kuptohet se si ka ardhur deri te një vendosje e tillë lidhur me mos pranimin e mënyrës së dorëzimit të prapësimit, nëpërmes postës. Nga shkresat e lëndës vërtetohet se urdhrin për lejimin e përmbarrimit debitori e ka pranuar me datë; 23.11.2019, ndërsa prapësimin e ka ushtruar nëpërmes postës, me dt.02.12.2019, që provohet me anë të kopertinës të

dorëzuar në post e cila dhe është e volosur, drejtuar përmbauesit Privat Rezarta Metaj e njehta gjindet në shkresa të lëndës, për më tepër i autorizuari i debitorit përmesë ankesës ka dorëzuar edhe dëftesën për pranimin e dërgesës nga ana e postës me nr. Serik; R- .... të datës 02.12.2019, i cili konsiderohet si dorëzim i rregullt i prapësimit në kuptim të dispozitës së neni 127 paragrafi 2 të LPK-së dhe i njëjti është i afatshëm në kuptim të dispozitës së nenit 70 të LPP-së, lidhur me nenin 126 paragrafi 1 pika 5 të LPK-së, pasi që është parashtruar brenda afatit prej 7 ditësh, gjegjësisht është pranuar në ditën e shtatë (7), andaj një qëndrim dhe përfundim juridik i gjykatës së shkallës së parë është jo i drejtë dhe i ligjshëm, andaj nga këto arsye është dashur që aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së dhomës së shkallës së parë në procedim të serishëm.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, të vlerësoj shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, duke vendosur në mënyrë meritore lidhur me prapësimin e debitorit e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

**GJYKATA E KOMERCIALE DHOMA E SHKALLËS SË DYTË NË PRISHTINË**  
K.DH.SH.II.nr.690/22, datë; 05.09.2022

Gjyqtarja  
Franciska Zhitija Ymeri